



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2022:013458

Datë: 05.04.2022

Numri i dokumentit: 02884542

**P.nr. 101/2022**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA SUHAREKË**- Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Lavdim Bajraktari me procesmbajtësen Blerina Halitjahaj zyrtare ligjore e kësaj gjykate, në çështjen penale kundër të akuzuarit Xh. M. nga fshati M. komuna Suharekë, për veprën penale dhuna në familje nga neni 248 parag. 1 lidhur me parag. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 06/L-074, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 166-14/2022 të datës 03.03.2022, në seancën e shqyrtimit gjyqësor jo publik, në prezencë të prokurorit të shtetit Beqë Shala, të dëmtuarës S. M., të akuzuarit dhe mbrojtësit av. Sh. S. nga Suhareka të angazhuar sipas detyrës zyrtare shpalli, ndërsa me datë 05.04.2022 përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

I akuzuari Xh. M. i biri i Q. dhe nënës Sh. e gjinisë V., i lindur më ..... në fshatin M. komuna Suharekë, me numër personal të letërnjoftimit ....., me vendbanim në fshatin M. komuna Suharekë, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në masën e paraburgimit nga data 22.01.2022 deri me datë 21.03.2022.

## ËSHTË FAJTOR

### Sepse,

Më datë 21.01.2022, rreth orës 23:20 minuta, në fshatin M., Komuna e Suharekës, saktësisht në shtëpinë e tij familjare, ushtron dhunë - keqtrajtim fizik, psikologjik dhe ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënieje familjare, përkatësisht ndaj vajzës së tij – të dëmtuarës S. M., në atë mënyrë që pasi e dëmtuara kthehet në shtëpi, në të cilën jeton me të pandehurin, nënën dhe vajzën e saj, e vëren se babai i saj ishte agresiv me familjarët, pasi e pyet nënën e saj se mos kishte konsumuar alkool ngase ishte duke përdorur terapi, i pandehuri e dëgjon dhe revoltohet duke sharë dhe ofenduar me fjalë fyese dhe del jashtë shtëpisë ku merr një mjet të rrezikshëm – armaturë, me të cilin tenton ta godas mirëpo e dëmtuara së bashku me vajzën e saj 13 vjeçare arrijnë të largohen nga shtëpia dhe gjatë lëvizjes me veturë, i pandehuri me mjetin e rrezikshëm e godet edhe veturën e të dëmtuarës, të gjitha këto veprime i ndërmer në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore, i diagnostifikuar sipas raportit për gjendjen mendore

nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike (datë 14.02.2022) me çrregullim mendor “somatik” gjë që në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij për të kuptuar veprën dhe për të kontrolluar sjelljet e tij ka qene e zvogeluar ne shkalle jo esenciale me ç’ rast tek e dëmtuara shkakton frikë, stres psikologjik, ankth dhe pasiguri.

**- me këto veprime ka kryer veprën penale dhuna në familje nga neni 248 parag. 1 lidhur me parag. 2 të Kodit 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).**

Gjykata Themelore në Prizren dega Suharekë në bazë të neneve neneve 4,7,17, 18 parag. 2, 38, 39 parag. 1 nënparag. 1.1, 40 parag. 1 nënparag, 1.2 dhe 1.3, 42, 43, 44, 69, 70, 84, parag.1 nen parag. 1.2, 86, 248 parag.1 lidhur me parag. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 06/L-074, neneve 365, 366, 367 parag. 1 nënparag, 1.2, parag. 4 nënparag. 4.3, 450, 461, 515 të Kodit të Procedurës Penal të Republikës së Kosovës (KPPRK) 04/L-123, të akuzuarin :

## E G J Y K O N

**1.Me dënim me burgim** ne kohëzgjatje prej 120 ditëve i cili dënim duhet të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë se ketij aktgjykimi. Koha e kaluar në paraburgim në kohëzgjatje prej 57 diteve i llogaritet në shqiptimin e dënimit ndërsa që për kohën e mbetur ne kohëzgjatje prej 63 ditësh me kërkesen e të akuzuarit dënimi me burgim i zevendesohet me dënim me gjobë në shumën prej 600 € euro, i cili dënim duhet te ekzekutohet 15 dite pas plotfuqishmërisë se ketij aktgjykimi. Nese i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, dënimin me gjobë do t’a zëvendësoj në dënim me burgim në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditësh, duke llogaritur që 20 € (një zetë) euro të dënimit me gjobë llogaritet me 1 (një) ditë burgim, dhe

**2.Me denim me gjobë** ne shumen prej 200 € (dyqind euro) i cili duhet te ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nese i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, dënimin me gjobë do t’a zëvendësoj në dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) diësh, duke llogaritur që 20 € (një zetë) euro të dënimit me gjobë llogaritet me 1 (një) ditë burgim.

**3.Ndaj të pandehurit shqiptohet masa e trajtimit te detyrueshëm psikaktrik në liri në Qendrën e Shëndetit Mendor në Prizren në kohëzgjatje prej 1 viti** pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**4.Obligohet Qendra e Shendetit Mendor në Prizren ta njoftoj gjykatën për zbatimin ose mos zbatimin kesaj mase.**

**5. Obligohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës penale, ashtu që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € (njëzetë euro), dhe në emër të taksës për kompenzim të viktimit të krimit shumën prej 30 € (tridhjetë euro), të gjitha këto pas plotëfuqishmerisë se këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyruar.**

**7.Bazuar në nenin 367 parag. 1 nen parag, 1.2, parag. 4 nen parag. 4.3 gjykata e nderpren masen e parburgimit dhe për kete do të merr aktvendim te veçantë.**

8.E dëmtuara S. M. nga M. ka hequr dore nga kërkesa pasurore juridike

### **A r s y e t i m**

Prokurori i shtetit i Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën me propozimin e masës trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në mënyrë ambulatore në liri, me numër PP.II.nr. 166-14/2022 të datës 03.03.2022, e ka akuzuar Xh. M. për veprën penale dhuna në familje nga neni 248 parag. 1 lidhur me parag. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 06/L-074, aktakuzë të cilën e ka përfaqësuar prokurori i shtetit Beqë Shala.

Para se të lexohet aktakuza gjyqtari ka kërkuar që për shkak të gjendjes shëndetësore të akuzuarit mendimin e eksperti i psikiatrisë se a është në gjendje i pandehuri për t'iu nënshtruar gjykimit, dhe deklaratimet e tij në seancë a janë valide. Ndërsa që eksperti i psikiatrisë J. Z. ka konstatuar se i akuzuari mund të merr pjesë në seancë gjyqësore mund të konsultohet me mbrojtësin e tij e kupton procedurën gjyqësore që është duke u zhvilluar ndaj tij dhe deklaratat e tij të dhena në gjykatë janë valide.

Pas konstatimit të faktit se i akuzuari mund të përballet me gjykimin dhe deklaratat e tij të dhena në gjykatë janë valide, prokurori i shtetit pas leximit të aktakuzës bëri përmirësimin e gabimit teknik të përvjedhur në dispozitiv ku në vendin ku ekziston konstatimi “sjellet e tij kanë qenë esencialisht e zvogëluar” e që duhet të jete “ka qenë e zvogëluar në shkallë jo esenciale”, pjesa tjetër e dispozitivit mbetet e pandryshuar.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i akuzuari deklarojë se e kuptoi në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohem, dhe lidhur me deklarinim lidhur me fajësinë ose pafajësinë e tij ka deklaruar se e pranon fajësinë, jam penduar për veprën të cilën e ka kryer, duke theksuar e dëmtuara është vajza ime dhe i kerkoi falje, i premtoj gjykatës se nuk do t'a përsërisë veprën e tillë.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. Shaqir Sedolli deklarojë se e mbështet deklarinimin e të mbrojturit të tij lidhur me pranimin e fajësisë konsideron se ky pranim ka mbështetje në nenin 248 të KPRK-se pasi që i akuzuari paraprakisht është njoftuar me të gjitha pasojat dhe benifitet e pranimin të fajësisë dhe këtë pranim e ben vullnetarisht me vetedije të plotë pa ndikim dhe presion, andaj gjykates i propozoj që me rastin e matjes se llojit dhe lartësisë së dënimit të merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë edhe pranë marrjes së deklaratës edhe në prokurori, kërkim fajlën ndaj të dëmtuarës këtu vajzës se tij, premtimin se nuk do të përsërisë veprën penale. Andaj duke i marrur parasysh të gjitha keto rrethana lehtësuese gjykata ti shqiptoi një dënim me të butë, ndërsa meqë kane pushuar kushtet për të cilën është caktuar masa e paraburgimit dhe meqë nuk mund të vazhdohet masa e tillë, gjykates i propozoj që ti ndërpritet masa e paraburgimit. Ndërsa sa i perket propozimit në aktakuzë për shqiptimin e masës për trajtim të detyrueshëm psikiatrik në liri e mbështes ngase i mbrojturi im ka nevojë për këtë trajtim.

E demtuara S. M. deklaron : qendroj pranë ndjekes penale për të pandehurin dhe që i njejtë të dënohet ndërsa nuk qëndron pranë kërkesës pasurore juridike

Pasi që gjykata ka urdhëruar përplimin e ekspertizës mjeko -ligjore për të pandehurin dhe gjithashtu eksperti psikoiater J. Z. ka marrë pjesë në përpilimin e ekspertizës nga grupi i

ekspertëve në elaborimin verbal të ekspertizës me numër 68/22 se dates 14.02.2022 të IPKF-së, deklaroi se ndaj të akuzuarit në mënyrë ambulantore nga shqyrtimi i dokumentacionit që gjendet në shkresat e lëndes dhe të dhenave heteroanamnestike, analiza e rasteve të ngjashme, punës ekipore dhe konsultimi i literatures, në ekip vlerësues kemi ardhur në përfundim se i ekzaminuari ynë vuan nga çrregullimi mendor që quhet çrregullim somatofor, e që në klasifikimin ndërkombëtar të sëmundjeve kodohet me F-45.0 ky çrregullim karakterizohet me ankesa të shumta trupore dhe me simptoma të atyre sistemeve nga të cilat ankon personi, ky çrregullim është kronik dhe i ndryshueshem dhe zakonisht është i percjellur me çrregullime në sjelleje sociale, interpersonale dhe familjare. Sa i përket ditës kritike për veprën të cilën akuzohet aftësia e tij mendore për ta kuptuar rëndësinë e veprës si dhe kontrolli ndaj veprimeve të veta ka qenë e zvogëluar në shkallë joesenciale. Ndërsa sa i përket natyrës së sëmundjes në ekip vlerësues nuk kemi propozuar ndonjë masë në ekspertizë por duke e parë gjendjen e tij aktuale edhe sot në seancë dhe çrregullimi nga i cili vuan mendojmë që i njëjti ka nevojë të trajtohet në mënyrë ambulantore në liri tek psikiatri e që ky shërbim mund të merret në Qendrën e Shëndetit Mendor në Prizren, dhe në qoftëse i njëjti u përmbahet këshillave të profesionistëve të shëndetit mendor dhe e përdore terapinë e përshkruar nga ana e psikiatrit rreziku për përsëritjen e veprës do të jetë me i ulët, në të kundërtën nëse i njëjti nuk i përmbahet atëherë gjykata ka të drejtë t'i shqipton ndonjë masë me kufizuese pasi që i njëjti mbrenda një kohe shumë të shkurtër e ka përsëritur veprën penale të dhunës në familje.

Gjyqtari vetëm gjykues pas deklarimit të akuzuarit mbrojtësit të tij, prokurorit të shtetit, të dëmtatës dhe ekspertit psikiatër, rreth pranimi të fajsisë ka marrë aktvendim me anë të cilit ka pranuar deklarimin e të akuzuarit për pranimin e fajsisë duke vlerësuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë sipas nenit 248 të Kodit të Procedurës Penal të Republikës së Kosovës (KPPRK) 04/L-123, gjyqtari ka përcaktuar se i akuzuari kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajsisë, se pranimi bëhet vullnetarisht nga e akuzuara, se pranimi i fajit mbështete në faktet e qështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke u bazuar në deklarimin e të akuzuarit për t'a pranuar fajësinë në tërësi për të gjitha pikat e aktakuzës, gjykata konform nenit 326 paragraf 4 kaloi në fjalën përfundimtare të palëve.

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit deklaroi se nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit në këtë shqyrtim në prani të avokatit mbrojtës dhe ekspertit të forenzikës dr. J. Z., ekspertizës psikiatrike nga ana e IPFK-së të grupit të ekspertëve vertetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale si në aktakuzë si dhe vlen të potencohet nga ekspertiza konstatimi se tek i pandehuri aftësia e tij mendore për të kuptuar rëndësinë e veprës si dhe kontrolli ndaj veprimeve të veta ka qenë e zvogëluar në shkallë jo esenciale njëherit gjykata gjatë marrjes së vendimit të dënimit të ketë parasysh edhe rekomandimin e ekspertit të psikiatrisë forenzike lidhur me trajtimin e tij.

Në fjalën përfundimtare mbrojtësi i të pandehurit deklaroi se pas dëgjimit të ekspertit dhe elaborimit të saj ku propozoi që i mbrojturi im të trajtohet në mënyrë ambulantore në liri, si mbrojtës i tij nuk e kundërshtoj një masë të tillë dhe mendoj se e njëjta do të ishte me efektive krahas dënimit.

Në fjalën përfundimtare e dëmtuara deklaroi se nuk ka çka të shtoj.

Nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat personale dhe provat materiale të pakontestueshme që përmban aktakuza në tërësi u vërtetua se:

Më datë 21.01.2022, rreth orës 23:20 minuta, në fshatin M., Komuna e Suharekës, saktësisht në shtëpinë e tij familjare, ushtron dhunë - keqtrajtim fizik, psikologjik dhe ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënieje familjare, përkatësisht ndaj vajzës së tij – të dëmtuarës S. M., në atë mënyrë që pasi e dëmtuara kthehet në shtëpi, në të cilën jeton me të pandehurin, nënën dhe vajzën e saj, e vëren se babai i saj ishte agresiv me familjarët, pasi e pyet nënën e saj se mos kishte konsumuar alkool ngase ishte duke përdorur terapi, i pandehuri e dëgjon dhe revoltohet duke sharë dhe ofenduar me fjalë fyese dhe del jashtë shtëpisë ku merr një mjet të rrezikshëm – armaturë, me të cilin tenton ta godas mirëpo e dëmtuara së bashku me vajzën e saj 13 vjeçare arrijnë të largohen nga shtëpia dhe gjatë lëvizjes me veturë, i pandehuri me mjetin e rrezikshëm e godet edhe veturën e të dëmtuarës, të gjitha këto veprime i ndërmer në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore, i diagnostifikuar sipas raportit për gjendjen mendore nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike (datë 14.02.2022) me çrregullim mendor “somatik” gjë që në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij për të kuptuar veprën dhe për të kontrolluar sjelljet e tij ka qene e zvogëluar ne shkalle jo esenciale me ç’ rast tek e dëmtuara shkakton frikë, stres psikologjik, ankth dhe pasiguri.

Gjendjen e tillë faktike gjykata e ka vërtetuar nga vetë pranimi i fajësisë në shqyrtimin gjyqësor, nga ana e të akuzurit si dhe nga provat dhe faktet e pa kontestueshme që i përmban aktakuza, siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër 2022-GB-.. i datës 21.01.2022 i stacionit policor në Suahrekë, Procesverbalin mbi intervizitimin e viktimës S. M. dhënë në polici me date 22.01.2022, Raporti i oficerit B. M. i datës 21.01.2021, Raporti mjekësor i QKMF në Suharekë për të dëmtuarën me numër .... të datës 22.01.2022, Procesverbalin mbi intervizitimin e të pandehurit dhene në polici me date 21.01.2022, Procesverbalin e marrjes se deklarates se të pandehurit Xh. M. dhënë në prokurori me date 30.04.2021, Ekspertiza e grupit te ekspertve te Psikiatrisë Forenzike ne Prishtinë me numër 68/22 së dates 14.02.2022.

Nga këto fakte dhe prova të konstatuara në shqyrtimin gjyqësor dhe nga vetë pranimi i fajësisë nga i akuzuari, nga veprimet e të akuzuarit përmbushën të gjitha elementet e veprës penale dhuna në familje nga neni 248 parag. 1 lidhur me parag. 2 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 06-L-074, të cilën e ka kryer me dashje direkte, duke ushtron dhunë - keqtrajtim fizik, psikologjik dhe ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënieje familjare, përkatësisht ndaj vajzës së tij – të dëmtuarës S. M. me ç’ rast tek e dëmtuara shkakton frikë, stres psikologjik, ankth dhe pasiguri.

Gjatë përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata për të akuzuarin pati parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 69,70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 06/L-074, andaj si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori faktin se e ka pranuar fajësinë, se ndihet i penduar dhe i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsërisë këtë vepër penale, se nga shkak i çrregullimit psikologjik veprën penale e ka kryer në gjendje të zvogëluar mendore në shkalle jo esenciale, është i moshës së shtyer dhe pensionist, ndërsa rrethana rënduese gjykata konstatoi se e ka përsërituar veprën penale të dhunës në famijle dhe është dënuar me aktgjykimin e kësaj gjykate me numër 217/2021 i datës 22.06.2021.

Për këtë vepër penale është paraparë denimi me gjobë ose burg deri në 3 vite, i akuzuari u gjykua sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se ky dënim është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjesisë penale të akuzuarës dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë që të parandaloi të akuzuarën nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe të bëjë rehabilitimin e saj si dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e

moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)06/L-074.

Vendimin mbi caktimin e masës së masa e trajtimit te detyrueshëm psikaktrik në liri në Qendrën e Shëndetit Mendor në Prizren, gjykate bazoi 84, parag.1 nënparag. 1.2, dhe 86 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)06/L-074.

Vendimin mbi paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në nenin 450 parag. 3 të Kodit të Procedurës Penal të Republikës së Kosovës (KPPRK) 04/L-123, ashtu që lartësia e paushallit gjyqësor në shumën prej 20 Euro u caktua duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmërinë e procedurës penale si dhe gjendjen financiare të të akuzuarës, ndërsa shumën prej 30 euro në emër të viktimave të krimit bazuar ne nenin 39 parag.3 të ligjit mbi kompensimin e viktimave të krimit nr. 05/L-036.

Vendimin lidhur me kërkesën pasurore juridike gjykata e bazoi në nenin 461 parag. 1 të Kodit të Procedurës Penal të Republikës së Kosovës ( KPPRK) 04/L-123, pasi që e dëmtura ka hequr dorë nga kjo kërkesë në seancën e shqyrtimit gjyqësor.

Vendimin lidhur me ndërprerjen e masës së paraburgimit gjykata e bazoi në nenin 367 parag. 1 nënparag, 1.2, parag. 4 nënëparag. 4.3, pasi kanë pushuar shkaqet për caktimi e kësaj mase.

Nga të lartcekurat është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË**  
**P.nr. 101/2022 datë 18.03.2022**

Zyrtarja ligjore  
Blerina Halitjaha

G j y q t a r i

Lavdim Bajraktari

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.